

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7923
E martë, 5 nëntor 2024
Çmimi 0.50

Zëvendëskryeministri i Luksemburgut premton 25 milionë euro investime në Kosovë



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com Gazeta "Epoka e re"



KËRKOHET URGJENCË E STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT PËR PARANDALIMIN E DIABETIT, TË TRAJTOHET NJËLLOJ SI SENSIBILIZIMI PËR KANCERIN



Spitali Regional i Pejës ngelet model i komunikimit me qytetarët falë strategjisë së komunikimit që ka përpiluar që nga koha e virusit Covid-19 e që po vazhdon të praktikohet deri më tani. Mirëpo profesorët universitarë, personat e prekur nga diabeti si dhe familjarët të cilët humbën më të afërtit e tyre nga sëmundja e diabetit, kanë bërë thirrje të ketë më shumë fushata vetëdijesuese dhe sensibilizuese për parandalimin e kësaj sëmundje. Madje u është bërë thirrje medieve ta kenë në fokus sektorin e shëndetësisë, respektivisht komunikimin me qytetarët me anë të këshillave nga profesionistët e fushës

MË 11 NËNTOR MBAHET SEANCA PËR BUXHETIN E VITIT 2025, OPOZITA THOTË SE NUK DO TA VOTOJË



GËRVALLA NË PRAG TË ZGJEDHJEVE NË SHBA: NUK SHOH SINJALE TË NDRYSHIMIT TË PËRKRAHJES PËR KOSOVËN




OPINION

DIÇKA PËR SLOGANIN E PDK-SË!

Shkruan: Artan BEHRAMI



AKTUALE



HARRISI DHE TRUMPI PËR BALLKANIN, LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE NDIKIMEVE KEQDASHËSE

SHQIPËRIA KONFIRMON RASTE ME GRIPIN E SHPENDËVE

EKONOMI



KËRKOHET NGA PROKURORIA QË URGJENTISHT T'I NISË HETIMET PËR BLOKIMIN E LLOGARIVE BANKARE TË TELEKOMIT TË KOSOVËS

NDRYSHON PROCEDURA E APLIKIMIT PËR SHITESA PËR FËMIJË, VENDOSEN AFATE TË REJA

SPORT



MALISHEVA FITON DERBIN NDAJ LLAPIT, BALLKANI DEKLASOI FERONIKELIN '74

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Harrisi dhe Trumpi për Ballkanin, luftë kundër korrupsionit dhe ndikimeve keqdashëse

WASHINGTON, 4 NËNTOR - Kandidatët presidencialë amerikanë thanë se lufta kundër korrupsionit dhe trysnive nga jashtë do të jenë përparësi e administratave të tyre në Ballkanin Perëndimor, ndërsa rajoni synon integrimet evropiane.

Një zëdhënës i fushatës së nënpresidentit Kamala Harris i tha "Zërit të Amerikës" se ajo ka mbrojtur vazhdimisht avancimin e demokracisë, sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit. "Lufta kundër korrupsionit është një interes thelbësor i sigurisë kombëtare të Shteteve të Bashkuara dhe një nga arsytet pse nënpresidentja Harris është plotësisht e përkushtuar për të çuar përpara aspiratat euroatlantike të të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. NATO-ja dhe Bashkimi Evropian mbështeten në vlerat e përbashkëta demokratike, duke përfshirë institucione të forta, të pavarura dhe të përgjegjshme", thuhet në përgjigjen e zëdhënësit, sipas të cilit, "vlerat tona gjithashtu mbrojnë dhe respektojnë të drejtat e qytetarëve dhe vendeve për ta shprehur lirisht identitetin e tyre kombëtar".

Ndërkaq në një letër drejtuar komunitetit shqiptaro-amerikan në prag të zgjedhjeve, Harrisi vuri theksin te lidhjet e veçanta ndërmjet amerikanëve dhe shqiptarëve prej më shumë se një shekulli, që nga Konferenca e Paqes në Paris pas Luftës së Parë Botërore. "Deri më sot shqiptaro-amerikanët kujtojnë që ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës që u angazhuan në atë moment vendimtar për pavarësinë e Shqipërisë. Dua ta konfirmoj

partneritetin e fortë midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë. Shqipëria është një aleat e qëndrueshme e NATO-s, dhe unë e vlerësoj Shqipërinë për promovimin e qëndrueshmërisë në rajon, si dhe për udhëheqjen e saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së gjatë muajve pas fillimit të agresionit brutal të Rusisë ndaj Ukrainës", thuhet në letër. "Shtetet e Bashkuara gjithashtu kanë udhëhequr aleatët dhe partnerët evropianë për ta mbështetur pavarësinë dhe sovranitetin historik të Republikës së Kosovës dhe vazhdojnë ta mbështesin një Kosovë shumetnike, demokratike, plotësisht të integruar në komunitetin ndërkombëtar", thekson në letër Harris.

Ndërkaq Christos Marafatsos, nga fushata e ish-presidentit Donald Trump, i tha "Zërit të Amerikës" se politika e jashtme e presidentit Trump ndaj Ballkanit Perëndimor "do të theksonte partneritetet pragmatike, të orientuara nga veprimet e përqendruara në qëndrueshmërinë, mundësitë ekonomike dhe luftimin e korrupsionit".

Sipas Marafatsos, një Shtëpi e Bardhë e udhëhequr nga zoti Trump nuk do të nxiste thjesht deklarata të gjera mbi demokracinë, por do të nxirrte rezultate reale dhe të përgjegjshme duke punuar drejtpërdrejt me udhëheqësit lokalë dhe qytetarët në rajon. "Presidenti Trump e kupton se paqja e vërtetë vjen nga kombe të forta dhe të vetëqëndrueshme. Administrata e tij do të përqendrohej në forcimin e ekonomisë dhe sigurisë së



vendeve të Ballkanit, duke u mundësuar atyre t'i rezistojnë si korrupsionit ashtu edhe trysnisë së jashtme. Kjo nënkupton mbështetjen e marrëveshjeve strategjike të tregtisë ekonomike dhe masave kundër korrupsionit, jo vetëm me fjalë, por përmes partneriteteve vepruese, ndarjes së burimeve dhe trajnimeve që forcojnë institucionet vendore. Për më tepër, administrata e tij do t'u jepte përparësi lirive individuale dhe do ta shkurtonte burokracinë që pengon përparimin në këto vende, duke ndihmuar në avancimin e vlerave të vërteta demokratike, duke fuqizuar qytetarët dhe institucionet lokale", tha ai. Fushata e Trumpit kritikoi politikën e jashtme të administratës së presidentit Joe

Biden për mosveprim dhe mungesë angazhimi për t'i kuptuar vërtetë sfidat e veçanta të rajonit. Sipas saj, mungesa e angazhimit jo vetëm që ka penguar përparimin ekonomik, por ka bërë që shumë vende të Ballkanit të ndihen të anashkaluara dhe të pavlerësuara ndërsa tensionet ziejnë. "Një administratë e zotit Trump do të sillte një qasje të re dhe të vendosur. Presidenti Trump do t'i jepte përparësi angazhimit të drejtpërdrejtë, duke punuar ngushtë me udhëheqësit lokalë dhe palët e interesuara për t'i trajtuar çështjet urgjente në secilin prej këtyre kombeve. Administrata e tij do të ndërmerre hapa aktivë për të parandaluar që ndikimet e huaja ta destabilizojnë rajonin, duke siguruar që Ballkani të

përparojë në një rrugë të qëndrueshme dhe të begatë", thuhet në përgjigjen e fushatës së Trumpit në të cilën theksohet se "stili dhe angazhimi vendimtar i tij për të ndërtuar aleanca të forta të mbështetura në përfitimet dhe respektin e ndërsjellë, do të qëndronin në kontrast të plotë me politikën pasive të administratës aktuale, duke u dhënë shpresë atyre që besojnë në një të ardhme më të ndritshme për Ballkanin". Vendet e Ballkanit po ndjekin me vëmendje fushatën për zgjedhjet e 5 nëntorit, rezultati i të cilave po pritët me shqetësim nga shumë evropianë për shkak të ndikimit që mund të kenë në të ardhmen e NATO-s, luftën e Rusisë në Ukrainë, marrëdhëniet tregtare dhe të ardhmen e demokracisë në kontinent.

Presidentja properëndimore e Moldavisë fiton mandatin e dytë



KISHNAU, 4 NËNTOR - Presidentja properëndimore e Moldavisë, Maia Sandu, fitoi një mandat të dytë në një balotazh të rëndësishëm presidencial kundër një rivali miqësor me Rusinë, në një garë që u përshkua nga pretendimet për ndërhyrje ruse, mashtrim dhe frikësim të votuesve në vendin kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Kur janë numëruar mbi 99 për qind të votave të hedhura në zgjedhjet e së dielës, Sandu doli me mbi 55 për qind sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa Alexandr Stoianoglo, një ish-prokuror i përgjithshëm, që mbështetej nga Partia e Socialistëve pro-ruse, fitoi mbi 44 për qind.

Në mbyllje të qendrave të votimit në orën 21:00 sipas kohës lokale, u tha se në votime morën pjesë më shumë se 1.68 milion vota, rreth 54 për qind e zgjedhësve me të drejtë vote.

Rezultati do të jetë një lehtësim i madh për qeverinë properëndimore, e cila mbështeti fuqimisht kandidaturën e Sandusit dhe përpjekjet e saj për lidhje më të ngushta me perëndimin në rrugën e Moldavisë drejt BE-së. "Moldavi, ti je fitimtare! Sot, të dashur moldavë, ju keni dhënë një mësim për demokracinë, të denjë për t'u shkruar në librat e historisë. Sot, ju keni shpëtuar Moldavinë! Në zgjedhjen tonë për një të ardhme dinjitoze, askush nuk humbi", tha Sandu.

Covid-19 dhe gripi sezonal, IKShPK bën thirrje për kujdes të shtuar për personat mbi 65 vjeç dhe me sëmundje kronike

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë thirrje për kujdes të shtuar për personat me sëmundje kronike, sidomos ata mbi moshën 65 vjeç, duke paralajmëruar se kjo kategori

është më e rrezikuar nga komplikimet e mundshme të Covid-19 dhe gripit sezonal. Në një deklaratë të fundit, IKShPK ka bërë thirrje për ndjekjen e masave të thjeshta mbrojtëse për t'i parandaluar sëmundjet respiratore dhe për

ta ruajtur shëndetin e individëve të cenushtëm. "Instituti rekomandon këto masa: Vaksinohuni sapo të keni mundësi. Qëndroni në shtëpi nëse ndiheni të sëmurë. Mbani maskë në vendet e mbushura me njerëz. Lani

duart shpesh. Ajrosni ambientet e mbyllura", ka njoftuar IKShPK. Mesazhi i IKShPK-së, me sloganin #SiVetëmTiMundesh, vjen në kuadër të kujdesit të vazhdueshëm për shëndetin publik pas pandemisë, me



qëllim të mbrojtjes së grupeve të rrezikuara nga sëmundjet e stinës dhe Covid-19.

Më 11 nëntor mbahet seanca për buxhetin e vitit 2025, opozita thotë se nuk do ta votojë

Grupet parlamentare të opozitës kanë bërë me dije të hënën se nuk do ta votojnë buxhetin për vitin 2025. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se buxhetet e miratuara ndër vite nga qeveria aktuale nuk kanë lënë kurrfarë gjurme as në zhvillim, as në mirëqenie dhe as në ekonomi. Ai ka thënë se deputetët e PDK-së nuk do ta votojnë këtë buxhet. Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se deputetët e tyre nuk do të votojnë për miratimin e këtij buxheti. Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka theksuar se gjatë seancës do të shqyrtohet përmbajtja e buxhetit, i cili nuk përfshin masa specifike për zhvillimin ekonomik dhe investimet strategjike

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Të hënën, më 11 nëntor, Kuvendi i Kosovës do të mbajë një seancë plenare, ku në rend dite do të jenë diskutimi dhe miratimi i projektbuxhetit të Kosovës për vitin 2025. Lajmin pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit e ka dhënë shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi. Ai ka thënë se gjatë seancës do të shqyrtohet përmbajtja e buxhetit, i cili nuk përfshin masa specifike për zhvillimin ekonomik dhe investimet strategjike. "Deputetët e LDK-së do të angazhohen aktivisht në diskutime për ta analizuar strukturën e propozuar të shpenzimeve dhe për ta vlerësuar ndikimin e buxhetit në shërbimet publike dhe mirëqenien e qytetarëve. Ne do të punojmë për të siguruar një planifikim më të drejtë dhe efikas të burimeve publike, duke mbrojtur interesat e qytetarëve dhe duke adresuar nevojat kyçe të vendit", ka thënë Gashi.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se buxhetet e miratuara ndër vite nga qeveria aktuale nuk kanë lënë kurrfarë gjurme as në zhvillim, as në mirëqenie as në ekonomi. Ai ka thënë se deputetët e PDK-së nuk do ta votojnë këtë buxhet. "Duke qenë plotësisht të bindur se Kosova mundet më mirë, ne nuk do ta votojmë këtë buxhet. Shpresën, mirëqenien dhe angazhimin për ta bërë më mirë Kosovën, do ta reflektojë në



buxhetin për vitin e ardhshëm, qeveria që do të dalë nga zgjedhjet e shkurtit me kryeministër Bedri Hamzën", ka thënë Tahiri. Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se ky është një buxhet që ua ka varrosur shpresën 80 mijë qytetarëve që punojnë në shtetin e Kosovës për një pagë të

dinjitetshme, duke theksuar se nuk do ta votojnë këtë buxhet. "Pra, ne nuk e votojmë këtë buxhet, sepse e shohim këtë buxhet si një instrument që është letërnjoftimi i kësaj qeverie. E ky letërnjoftim është mbajtur pezull për katër vjet, fillimisht me Ligjin e Pagave, pastaj me koeficientin dhe në fund s'ka ndodhur asgjë", ka thënë ai.

Tahiri ka thënë se ky buxhet nuk ka asnjë projekt kapital të rëndësishëm. "Është një buxhet që nga ne do të kundërshtohet fuqishëm dhe është buxhet që do të rishikohet në mars të vitit të ardhshëm", ka thënë Tahiri. Ndërkaq shefja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se ata e kanë shumicën parlamentare dhe se sa

i përket deklaratimit të opozitës se nuk do ta votojë buxhetin, ka thënë se është çështje e vendimmarrjes së saj. "Ne e kemi shumicën parlamentare. Për opozitën s'kam çfarë të them. Është çështje e vendimmarrjes së saj. Qëndrimin e grupit parlamentar të LV-së mund ta dëgjoni në seancë", është shprehur Kusari-Lila.

Uji i liqenit të Badovcit ende nuk mund të përdoret për pije

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka vazhduar monitorimin e ujit për pije të Ujësjellësit Rajonal KRU "Prishtina" që vjen nga liqeni i

Badovcit. Rezultatet nga analizat e ditës së diel (03.11.2024) tregojnë se vlerat e manganit sillen: Më e ulëta 0.151 mg/l (Lagja Qëndresa) deri te më e larta:

0.467 mg/L (Rr. Hyzri Talla - Kodra e Diellit). Bazuar në të dhënat si më lart, uji në tërë zonën e furnizimit nga Liqeni i Badovcit (PR 03) ende nuk mund të përdoret për pije.

IKShPK në bashkëpunim me Ujësjellësin Rajonal KRU "Prishtina" do të vazhdojnë monitorimin e rregullt të ujit dhe popullata do të mbahet e informuar.



Gërvalla në prag të zgjedhjeve në ShBA: Nuk shoh sinjale të ndryshimit të përkrahjes për Kosovën

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Ministria e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, ka thënë të hënën se nuk ka parë ndonjë shenjë se mbështetja e Shteteve të Bashkuara për Kosovën mund të pësojë ndryshime pas zgjedhjeve presidenciale të 5 nëntorit në ShBA. "Jemi me fat që në ShBA kemi pasur mbështetjen e të dyja kampeve, pra të atij republikan dhe atij demokrat. Prandaj, nuk shoh asnjë sinjal që një gjë e tillë të ketë ndryshuar gjatë rrugës", tha Gërvalla kur u pyet në një konferencë për medie se çfarë pret në marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe ShBA-së pas zgjedhjeve atje të martën. Në garë për presidentin e ardhshëm amerikan janë Kamala Harris, nga Partia Demokratike, aktualisht nënpresidente, dhe Donald Trump, nga Partia Republikane dhe president nga viti 2017 deri më 2021. Gërvalla tha gjatë konferencës së përbashkët në Prishtinë me ministrin e Jashtëm të Luksemburgut, Xavier Bettel, se Kosova do t'i forcojë marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara duke i kryer "detyrat e shtëpisë". "Duke çuar përpara agjendat e reformave dhe duke vendosur ligjin në çdo cep të Kosovës,



duke luftuar krimin e organizuar, kështu forcohet partneriteti me ShBA-në. Nuk forcohet me fjalë dhe deklarata, por me punë konkrete", tha ajo. Administrata e tanishme amerikane, ku bën pjesë Harris, ka inkurajuar vazhdimisht Kosovën t'i normalizojë marrëdhëniet me Serbinë, si kusht për të ecur përpara në rrugën e integritimit evropian, ndërsa Trumpi si president ka qenë dëshmitar i

nënshkrimit të një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike. Për analistët në ShBA situata nuk do të jetë aq e thjeshtë, megjithatë. Fillimisht, me luftën në Ukrainë, konfliktin në Lindjen e Mesme dhe kontestin territorial në Detin e Kinës Jugore, Kosova nuk do të depërtojë lart në agjendë, sipas tyre. Frank Wisner, ish-emisar i

ShBA-së për statusin e Kosovës, tha për programin "Expose" të "Radios Evropa e Lirë" javën e kaluar se problemi më i madh i Kosovës është mosmarrëveshja me Serbinë, e cila vazhdon të mos ia njohë pavarësinë, edhe gati 17 vjet pas shpalljes. Wisner nuk pret ndonjë lëvizje në këtë drejtim nëse Harris zgjidhet presidente. David Phillips, drejtor i Programit për Ndërtimin e Paqes dhe të Drejtat e Njeriut

në Universitetin e Kolumbias, shpreh pikëpamje të ngjashme për Harrisin, pasi nuk pret ndonjë veprim domethënës prej saj në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Por, për Trumpin, pritshmëritë janë dukshëm më shqetësuese. Të dy ekspertët druajnë se qasja e tij "transaksionale" mund të çojë në pasoja të paparashikueshme dhe potencialisht të rrezikshme për të ardhmen e Kosovës. Wisner nuk e përjashton mundësinë që Trumpi ta eksplorojë ndarjen e Kosovës si zgjidhje të shpejtë për konfliktin e saj të vazhdueshëm me Serbinë, duke e kujtuar një marrëveshje për shkëmbim terriore në mes të Kosovës dhe Serbisë përgjatë vijave etnike, e përfolur në vitin 2020, gjatë mandatit të parë presidencial të Trumpit. Phillips tha, po ashtu, se Trumpi e sheh ndarjen e Kosovës si zgjidhje të shpejtë për marrëdhëniet e saj të trazuar etnike dhe kjo, sipas tij, jo vetëm se do ta destabilizonte Kosovën, por do ta hapte Kutinë e Pandorës edhe në shtete të tjera multietnike të Ballkanit, si Maqedonia e Veriut, Bosnjë-Hercegovina apo Serbia.

Kurti takoi ministrin federal të Ekonomisë së Austrisë, flasin për marrëdhëniet e rëndësishme mes dy vendeve

VJENË, 4 NËNTOR - Në Vjenë të Austrisë kryeministri Albin Kurti takoi ministrin federal të Punës dhe Ekonomisë së Austrisë, Martin Kocher, me të cilin diskutuan për marrëdhëniet e rëndësishme ndërmjet Kosovës dhe Austrisë, rolin dhe kontributin e diasporës dhe për mundësitë e reja të bashkëpunimit në ekonomi, tregti, turizëm dhe zhvillim rural. Sipas një njoftimi për medie, bëhet me dije se Kurti shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vazhdueshme të Austrisë ndaj Kosovës, veçanërisht nëpërmjet projekteve të Agjencisë Zhvillimore (ADA), të cilat arrijnë vlerën prej 26 milionë eurosh. "Përkrahja nga kjo Agjenci ka luajtur rol instrumental në zhvillimin e shumë projekteve të rëndësishme për vendit,



përfshirë këtu programin tonë për arsim dual. Duke folur për partneritetin

ndërmjet Kosovës dhe Austrisë, Kurti theksoi se Austria është një nga

investitorët kryesorë në vendin tonë. Sipas Bankës Qendrore, shumica e

investimeve direkte nga Austria është gati gjysmë miliard euro, ndërkaq kontributi i saj në sektorë, si ai i bankës, sigurimeve dhe telekomunikacionit, ka ndikuar në rritjen tonë ekonomike. Me këtë rast, Kurti bëri thirrje që kompanitë austriake t'i hulumtojnë mundësitë dhe të angazhohen edhe në projekte të fushës së energjisë dhe infrastrukturës, në kuadër të investimeve që parashihen për tranzicionin energjetik të Kosovës dhe organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030", thuhet në njoftim. Kryeministri Kurti dhe ministri Kocher biseduan edhe rreth bashkëpunimit rajonal, Tregun e Përbashkët Rajonal, Planin e Rritjes të BE-së, si dhe anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Ky ishte takimi i parë ndërmjet tyre.

Diçka për sloganin e PDK-së!



Shkruan: Artan
BEHRAMI

Asnjë parti nuk i fiton zgjedhjet me slogane! Të gjitha sloganet politike janë të interpretueshme. Sloganet krijohen për të orientuar përkrahësit rreth programit që ofron një parti politike. Si dikush që ka studiuar Komunikim Politik, që ka punuar në fushata zgjedhore që nga viti 2009, sloganet në

shumicën e rasteve janë pozitive, thërrasin për shpresë, për unitet, për ndryshim, për reformë. Ato gjithmonë ndërtohen duke analizuar imazhin dhe partinë, potencialin e kandidatit, rrethanat politike, diskursin publik, oponentët etj. Albin Kurti dhe Vjosa Osmani në dy dekadat e fundit kanë gërryer thellë në këtë shoqëri, duke nxjerrë në sipërfaqe urrejtjen, çmendurinë, padurimin, hysterinë që çdo popull e shfaq kur në krye ka njerëz të çmendur. Ata kanë hasmëruar familje, miqtë, partinë - gjithë shoqërinë. Slogani i PDK-së nuk është detyrë vetëm për PDK-në, por për Kosovën! Ka njerëz

që mendojnë njëjtë si Kurti dhe Osmani. Kërkojnë një slogan që tregon se çfarë ka shkuar keq dhe nuk japin përgjigje se çka mundet më mirë! Prandaj, sloganin e Bedri Hamzës fton qytetarët për unifikim, për ndryshim, për reformë, për transformim, për shpresë së Kosova mundet më mirë! Ky slogan sulmon po ashtu përcaktimin artificial që është ndërtuar se Albin Kurti qenka shpresa e fundit! Slogani nuk është një antipod i "Krejt dhe Drejt", që iu ka dedikuar vetëm një lloji të caktuar të votuesve. Rrjedhimisht, "Kosova mundet ma mirë" nuk është kundër votuesve të VV-së, të LDK-së, AAK-së etj. Në fakt sloganin iu

bën pikërisht thirrje edhe atyre që t'i bashkohen vizionit të Bedri Hamzës. Slogani amnistion edhe ata që tashmë janë bindur se kanë bërë gabim të madh që kanë votuar Kurtin. I fton ata në një mes, ku ndërrimi i votës nuk do të shihet si tradhti, por si ndryshim racional. Pra, sloganin nuk është përjashtues, nuk është radikal, por përbashkues që synon unifikimin e qytetarëve! Qytetarët e Kosovës kanë prioritete, nevoja krejtësisht tjera-të ndryshme prej asaj që prodhon urrejtja e verbër! Pra, "Kosova mundet ma mirë" nuk është slogan i një partie, por i një populli, të cilit i bëhet ftesë të bashkohen rreth vizionit që

Kosovën e bëjnë vend më të mirë, shtet më të mirë, aleat më të mirë! Në fakt, një video që u lëshua në Konventë e shpjegoi më së miri sloganin e Bedri Hamzës. Aty, mjekë, studentë, mësime, qytetarë shpjegojnë se çfarë nënkupton "ma mirë" për ta! Që dy dekada partinë politike na ligjërojnë se çfarë është keq, për t'i ikur pyetjes përcaktuese: "Çfarë mundemi të bëjmë ma mirë"? Ka ardhur koha që kjo të ndryshojë! Bedri Hamza ka hyrë me shumë vetëbesim në këtë garë, duke ofruar një platformë që pritet të dëshmojë se "Kosova mundet ma mirë".


Zëvendëskryeministri i Luksemburgut premtion 25 milionë euro investime në Kosovë

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Zëvendëskryeministri, njëherësh ministër i Jashtëm dhe i Tregtisë së Luksemburgut, Xavier Bettel, në konferencën e përbashkët për medie në Prishtinë me ministrin Donika Gërvalla, ka thënë se Kosova ka vuajtur shumë nga vendimet e marra nga të tjerët dhe se ajo e meriton të jetë storie suksesi. Bettel ka potencuar se synimi i vendeve evropiane është të shmangët çfarëdo lloj lufte në Ballkan. "Jam këtu që për ta ndihmuar Kosovën në fusha të ndryshme dhe do të jenë rreth 25 milionë euro investime në këto projekte

kreative e në sektorë të IT-së, sepse është e rëndësishme për situatën tuaj ekonomike", ka thënë ai. Ai ka shtuar se "ky rajon ka vuajtur mjaft për vendimet që janë marrë nga të tjerë dhe ju e dini se unë do të kem përgjegjësinë edhe të Komitetit në Këshill të Evropës ku ju së bashku do të punoni për t'i dhënë Kosovës vendin që meriton dhe respektin që meriton dhe, gjithashtu, mundësinë për të qenë një storie suksesi siç e meriton". "Për të qenë anëtar i BE-së është rrugë e gjatë për t'u kaluar", ka shtuar Bettel.



Shqipëria konfirmon raste me gripin e shpendëve



TIRANË, 4 NËNTOR - Ministria e Bujqësisë në Shqipëri konfirmoi praninë e gripit të shpendëve në një fermë, por theksoi se asnjë njeri nuk është prekur nga kjo sëmundje. Vatra e gripit të shpendëve (H5N1) u zbulua më 2 nëntor në fshatin Mëzez, në periferi të Tiranës. Pas konfirmimit të rastit, Ministria e Bujqësisë tha se Instituti i Shëndetit Publik ka analizuar 90 mostra në këtë vatër, por të gjitha kanë rezultuar negative sa i përket prekjes së njerëzve nga gripin e shpendëve. Gjatë fundjavës që shkoi, sipas autoriteteve, janë monitoruar 2304 ferma, në të cilat

mbarështohen 96 900 shpendë të kategorive dhe llojeve të ndryshme. Me urdhër të Ministrisë së Bujqësisë është ndaluar lëvizja e shpendëve nga fermat e zonave të bashkive: Tiranë, Vorë dhe Kamëz. "Laboratori në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, që është përgjegjës për testimin e kampioneve lidhur me influencën aviare, ka marrë masat për t'u përgjigjur situatës emergjente lidhur me izolimin e rastit dhe parandalimin e përhapjes së infeksionit. Kampionet në njerëz të marra janë testuar nga Instituti i Shëndetit Publik

dhe kanë rezultuar negative", u tha në njoftimin e Ministrisë së Bujqësisë. Ministria e Bujqësisë tha se po bashkëpunon me Institutin e Shëndetit Publik, i cili po kryen mbikëqyrje të përforsuar për infeksionet respiratore në zonën e fermës së prekur nga sëmundja. Autoritetet shqiptare thanë se masat kufizuese dhe parandaluese do të jenë në fuqi deri në përfundimin e afatit të karantinës. Ndërkaq, Qendrat Kombëtare dhe Rajonale të Krizës u tha se do ta vazhdojnë koordinimin dhe funksionin e tyre deri në mbylljen e rasteve.



Kërkohet urgjencë e strategjisë së komunikimit për parandalimin e diabetit, të trajtohet njëllë si sensibilizimi për kancerin

Spitali Regional i Pejës ngelet model i komunikimit me qytetarët falë strategjisë së komunikimit që ka përpiluar që nga koha e virusit Covid-19 e që po vazhdon të praktikohet deri më tani. Mirëpo profesorët universitarë, personat e prekur nga diabeti si dhe familjarët të cilët humbën më të afërtit e tyre nga sëmundja e diabetit, kanë bërë thirrje të ketë më shumë fushata vetëdijesuese dhe sensibilizuese për parandalimin e kësaj sëmundje. Madje u është bërë thirrje medieve ta kenë në fokus sektorin e shëndetësisë, respektivisht komunikimin me qytetarët me anë të këshillave nga profesionistët e fushës

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Ishte pandemia Covid-19 që aktivizoi shumë institucione shëndetësore në mbarë globin që të fillojnë ta shohin me urgjencë ndryshimin e komunikimit me popullatën, respektivisht praktikimin e strategjisë së komunikimit publik me qytetarët, e një gjë të tillë e bëri edhe Spitali i Pejës, për çka sot e asaj dite Spitali Regional i Pejës llogaritet të jetë shembull i mirinformimit të qytetarëve për regjionin e Dukagjinit për shkak të dhënies së këshillave

shëndetësore diabetike si dhe lidhjen e doktorëve me qytetarët me anë të medieve sociale. Për zanafillën e krijimit të strategjisë së komunikimit dhe rëndësinë e komunikimit publik me qytetarët, ka folur zëdhënësi i Spitalit Regional të Pejës, Naim Sahiti. Ai ka treguar edhe format e komunikimit me pacientët. “Këtë praktikë të komunikimit me publikun e kemi filluar në kohën e pandemisë. Kemi pasur një rekord të hatashëm të njerëzve që kanë qenë aktivë dhe që na kanë përcjellë, mirëpo këtë praktikë të mirë që e kemi bërë atëherë, e bëjmë edhe sot”, ka thënë ai.

Zëdhënësi i Spitalit të Pejës, Naim Sahiti, ka thënë për gazetën “Epoka e re” se i shfrytëzojnë tri forma të komunikimit me publikun: komunikimin përmes broshurave, postierëve dhe rrjeteve sociale. “Besoj jemi në nivelin e kënaqshëm në kuptimin e komunikimit me publikun. Ne bëjmë publikime ditore të raporteve të punës, i informojmë qytetarët për shërbimet, por sigurisht që bëjmë prezantimin edhe të mjekëve e kështu me radhë”, ka thënë Sahiti. Ai ka theksuar se me anë të informimit publik, bëjnë fushata vetëdijesuese për

pacientët, duke dhënë kështu dhe mesazhet e duhura.

Ai shtoi se informimin publik e kanë obligim, ndaj është shprehur i kënaqur me feedbackun që marrin nga qytetarët e rrafshit të Dukagjinit. “Është e rëndësishme të bëjmë fushata sensibilizuese që përmes edukimit shëndetësor të bëjmë publikime të shumta, si lloj mesazhi që vlen për pacientët. E kemi parë që është nevojë dhe është detyra e jona komunikimi, sepse ndihmon në parandalimin e sëmundjeve. Transparencën e kemi edhe obligim ligjor. Sa i përket feedbackut, kemi matjen, qoftë përmes medieve sociale, emailëve dhe nga qytetarët”, ka deklaruar ai.

Sahiti ka thënë se vazhdimisht postojnë materiale shkencore të shkruara nga doktorët, qoftë për këshillim ndaj diabetikeve ashtu edhe për parandalimin e kësaj sëmundje. “Qytetarët zakonisht pyesin për shërbimet që mund t’i marrin në institucionin tonë. Sigurisht se fushatat vetëdijesuese që i kemi kanë të bëjnë me materialet e shkruara nga mjekët tanë që japin këshilla

për pjesën e parandalimit dhe menaxhimit të diabetit”, u shpreh ai.

Formë tjetër të komunikimit me publikun, zëdhënësi i Spitalit të Pejës, Naim Sahiti, ka përmendur edhe bisedat përmes rrjeteve sociale të doktorëve me qytetarët. “Për muajin nëntor për çdo vit organizojmë edhe biseda përmes rrjeteve sociale me pacientë. Ata kanë mundësi që direkt t’i bëjnë pyetjet për mjekët tanë për tema të ndryshme, por një ndër temat është edhe diabeti”, u shpreh ai.

Profesori Krasniqi thotë se duhet aktivizim më i madh i medieve dhe ekspertëve shëndetësorë për informimin e drejtë të sëmundjes së diabetit

Profesori universitar në Fakultetin e Filologjisë, Dega Gazetari, Milazim Krasniqi, ka folur për rolin dhe rëndësinë e medias në mirinformimin e publikut sa i përket diabetit. Ai ka thënë për gazetën “Epoka e re” se roli i gazetarisë është në

Kërkohet nga Prokuroria që urgjentisht t'i nisë hetimet për bllokimin e llogarive bankare të Telekomit të Kosovës

PRISHTINË, 4 NËNTOR - U bë një muaj që nga bllokimi i llogarive bankare të Telekomit të Kosovës, një veprim i ndërmarrë nga përmbartësi me urdhër të ish-pronarëve të "Z Mobile". Ky akt ka lënë mijëra punëtorë pa paga mujore dhe ka bllokuar funksionimin e përditshëm të Telekomit të Kosovës, duke krijuar situatë alarmante për të ardhmen e kompanisë dhe të punëtorëve të saj. Kështu thuhet në një reagim të Federatës Sindikale të Pavarur të Postës dhe

Telekomunikacionit të Kosovës, ku theksohet se derisa ata përballen me pasojat e kësaj afere të gjatë, siç theksojnë, që ka gërryer Telekomit të Kosovës ndër vite, institucionet e drejtësisë vazhdojnë të heshtin. "Mungesa e veprimit nga ana e tyre jo vetëm që inkurajon padrejtësinë, por gjithashtu sinjalizon mosinteresim për mbrojtjen e interesave të punëtorëve dhe të pronës publike. Kërkojmë dhe apelojmë urgjentisht: 1. Veprim nga Prokuroria - që të

nisë hetimet për këtë çështje dhe të ndjekë penalisht të gjithë ata që kanë kontribuar në krijimin dhe vazhdimin e lidhjeve korruptive të kësaj kompanie që ka dëmtuar Telekomit të Kosovës. 2. Marrje masash nga institucionet relevante, për të garantuar që punëtorët të marrin pagat e tyre dhe që Telekomit të çlirohet nga çdo ndërhyrje e padrejtë që po e shkatërron funksionimin dhe qëndrueshmërinë e tij. 3. Shkëputje të plotë nga çdo kontratë e dyshimtë dhe



kriminale - për të rikthyer integritetin dhe transparencën e Telekomit dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme për punëtorët dhe për kompaninë. Si përfaqësues të punëtorëve, ne

jemi të vendosur në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe në kërkimin e drejtësisë për një kompani që ka mbetur peng i lidhjeve kriminale dhe korruptive", thuhet në njoftim.

AUV-i garanton për sigurinë ushqimore, pavarësisht prej bagëtive të sëmura

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Më shumë se 260 bagëti në Kosovë kanë rezultuar pozitive për tuberkuloz dhe brucelozë këtë vit, duke ngritur shqetësime për sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik. Në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) thonë se janë duke bërë përpjekje të vazhdueshme për kontrollin e këtyre sëmundjeve infektive, të cilat nuk kërcënojnë vetëm bagëtitë, por mund të transmetohen edhe te njerëzit. Për pasojë, disa kafshë janë asgjësuar dhe disa të tjera pritet ta kenë të njëjtin fat, thotë Lamir Thaçi, zëdhënës në AUV.



Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ai shpjegon se këtë vit Agjencia ka pasur në agjendë 1 695 ferma në të gjithë Kosovën, për të analizuar mbi 20 000 gjedhe. "Pas aplikimit të testit dhe përfundimit të rezultateve, deri më tash kanë rezultuar 42 raste me 264 gjedhe të infektuara", thotë ai. Pavarësisht kësaj, Thaçi siguron se nuk ka nevojë për t'u shqetësuar për sigurinë e produkteve me bazë shtazore, sepse AUV-i, siç thotë, e ka situatën në kontroll. Gjatë tetorit AUV-i ka bërë disa njoftime në "Facebook" për asgjësimin e gjedheve që kanë rezultuar pozitive me këto sëmundje. Megjithatë, nga komentet në rrjetet sociale, duket se disa qytetarë i kanë reduktuar produktet me origjinë shtazore. Një prej tyre është Elvane Beqaj, e cila, duke folur për Radion Evropa e Lirë në Prishtinë, thotë se me mish furnizohet vetëm në një

mishtore ku pronarin e ka të njohur. "Dyshoj në cilësi dhe blej shumë pak produkte në dyqane. Edhe qumështin, kosin e djathin i blej në treg, pasi i njoh fermerët", tregon ajo. Për Thaçin, siguria ushqimore është në nivel. Ai thotë se jo vetëm produktet me origjinë shtazore, por të gjitha ushqimet që janë treg konsiderohen të sigurta pasi inspektorët bëjnë kontrolle të vazhdueshme tek të gjithë operatorët që merren me prodhimin e ushqimeve, përfshirë thertoret, mishtoret, qumështoret e të tjera. "AUV-i vazhdon ngritjen e kapaciteteve për rritjen e nivelit të sigurisë si për mish ashtu edhe për produkte të tjera shtazore", thotë Thaçi.

Veterineri Bledion Rushiti, anëtar i Kryesisë në Odën e Veterinarëve të Kosovës, nuk beson se situata është shqetësuese. "Fermerët janë të vetëdijshur se kur kafshët janë pozitive me këto sëmundje, ata nuk e dërgojnë qumështin për

përpunim në qumështore", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë". Valdet Gjinovci, profesor i Toksikologjisë së Ushqimit në Fakultetin e Bujqësisë në Mitrovicë, sugjeron qytetarët - për të qenë 100% të sigurt - që të mos konsumojnë këto ushqime pa i përpunuar. "Ata vetëm duhet ta ziejnë qumështin, kurse mishin ta përgatisin në temperaturë të lartë", thotë Gjinovci për "Radion Evropa e Lirë".

Ku groposen kafshët e infektuara?

Por, Jahir Krasniqi, një qytetar tjetër nga Prishtina, ka edhe një shqetësim: ku groposen kafshët e infektuara? "Institucionet duhet t'i informojnë qytetarët dhe t'i bindin se ato kafshë janë asgjësuar dhe ne jemi të sigurt të furnizohemi me produkte vendore", thotë ai. "Pse nuk po tregojnë se ku i kanë asgjësuar, saktësisht? Unë kam kujdes të shtuar në blerjen e këtyre

produkteve, sidomos të mishit, sepse nuk di...", thotë Krasniqi. Duke iu përgjigjur këtyre shqetësimeve, Thaçi nga AUV-i thotë se të gjitha kafshët që rezultojnë pozitive me sëmundje, asgjësohen nga ekupe profesionale të kompanisë së kontraktuar.

I gjithë procesi, sipas tij, mbikëqyret nga inspektorët veterinarë të AUV-it dhe kafshët nuk lejohet të lëvizin nga ferma deri në momentin që të bëhet asgjësimi. "Autoriteti, me ta marrë rezultatin, e vendos [kafshën e infektuar] në masë karantine. Pastaj, me hapa të shpejtë, me përgatitjen e kushteve teknike dhe caktimin e lokacioneve nga komunat, bëhet asgjësimi", shpjegon Thaçi.

Me ligjin në Kosovë mbetet shtazore apo kafshët e ngordhura groposen në lokacione të përshtatshme, që nuk ndikojnë në ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit. Secila komunë e ka obligim të caktojë një lokacion të sigurt ku nuk ka rrezik potencial për përhapjen e sëmundjeve te njerëzit.

Sipas statistikave zyrtare, në Kosovë jetojnë rreth 500 mijë kafshë, përfshirë gjedhe, dele, dhi e derra.

Importi prej jashtë

Kosova edhe importon kafshë të gjalla dhe produkte me origjinë të kafshëve.

Sipas të dhënave të siguruar nga Dogana e Kosovës, vitin e kaluar vlera financiare e këtyre

produkteve të importuara ka qenë rreth 283 milionë euro.

Rreth 83 milionë euro ka qenë vetëm vlera e kafshëve të importuara për therje ose mbajtje. Deri më tash këtë vit janë importuar kafshë në vlerë prej më shumë se 72 milionë eurosh.

Importi i tyre bëhet kryesisht nga vendet e Bashkimit Evropian, si Kroacia, Hungaria, Gjermania, Çekia, Franca, por edhe nga ato të rajonit, si Maqedonia e Veriut.

"Radio Evropa e Lirë" nuk arriti të siguronte informacione nga institucionet e shtetit në Maqedoni të Veriut, por Rinisa Rexhepi, nga organizata "Amos Pet" në Shkup, tha se ky vend nuk ka të dhëna të sakta për numrin e kafshëve me tuberkuloz dhe brucelozë.

Nga informatat që ka kjo organizatë, në katër vjetet e fundit kanë qenë vetëm tri raste të qenve me brucelozë, të testuara nëpërmjet laboratorëve. Sipas Rexhepit, numri mund të jetë edhe më i lartë se kaq, por prapëseprapë "në nivel minimal".

Në Shqipëri, ndërkaq, ka pasur raporte për kafshë të infektuara dhe për kalimin e sëmundjes së tyre te njerëzit. Ministria e Bujqësisë e këtij vendi nuk iu përgjigj pyetjes së "Radios Evropa e Lirë" se sa është numri i kafshëve të infektuara këtë vit. Por, mediet atje raportuan për infektimin e së paku 11 qytetarëve nga sëmundjet e kafshëve. Sipas Doganës së Kosovës, vendi nuk importon kafshë të gjalla nga Shqipëria, por importon produkte të qumështit.

Ndryshon procedura e aplikimit për shtesa për fëmijë, vendosen afate të reja

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Platforma e-Kosova ka bërë me dije se me vendim të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve janë vendosur afate dhe kushte të reja për aplikimin për shtesa për fëmijë.

Qytetarët tash e tutje mund të aplikojnë vetëm nga data 1


deri më 10 të çdo muaji. Këto afate vlejnjë për të gjithë ata fëmijë të cilët deri tash nuk kanë aplikuar për shtesa. "Ju informojmë se nga ky muaj me vendim të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve janë bërë disa ndryshime në procedurat e aplikimit për shtesa për fëmijë.

Afati për aplikim është i hapur nga data 1 deri më 10 të çdo muaji", thuhet në njoftim. Për më tepër, aplikimi për shtesa për fëmijë duhet të kryhet brenda tre muajve të parë të lindjes së fëmijës.

Në rast se aplikimi nuk bëhet brenda këtij afati, kërkuesit duhet të kalojnë përmes një

proces verifikimi për ta vijuar aplikimin.

Qytetarët ftohen t'i respektojnë këto afate për ta garantuar përpunimin e aplikimit në kohë. Për informata të mëtejshme qytetarët mund t'i referohen vendimit të ministrisë në platformën e-Kosova.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Inveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ademi për skandalin në Çeki: Kosova është një realitet i pakthyeshem

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka reaguar rreth ngjarjes së fundit në Pragë. Në "Facebook", Ademi ka shprehur se FFK-ja do t'i mbështesë lojtarët dhe do të jenë gjithmonë afër me kapacitetet dhe mundësitë e veta. Ademi ka thënë se do të ankohet rreth kësaj që ndodhi të shtunën e kaluar në ndeshjen Sparta Pragë - Banik Ostrava, ku

tifozët vendas shpaleshën flamuj me mbishkrimin "Kosova është Serbi". "Si president i Federatës së Futbollit të Kosovës, shpreh shqetësimin e thellë për incidentin e fundit në kampionatin çek, i cili prek dhe sfidon identitetin tonë shtetëror dhe është fyes ndaj futbollistëve tanë. Ky veprim është i papranueshem dhe nuk përkon me frymën e respektit dhe miqësisë që futboli duhet

të promovojë. U bëj thirrje futbollistëve tanë që përfaqësojnë Kosovën me krenari në klubet e tyre, që të vazhdojnë të mbeten të përkushtuar dhe profesionistë, duke mos u ndikuar nga provokime të tilla, pavarësisht se nga kush vijnë. Në këtë frymë, u drejtohem drejtuesve të klubit Sparta Pragë, si dhe mikut tim Petr Fousek, president i federatës çeke, duke

u kërkuar që t'i ndalojnë këto provokime dhe të mbrojnë futbollistët shqiptarë, të cilët janë shembull i profesionalizmit dhe angazhimit në fushën e blertë. Me këtë rast u them Albion Rrahmanit, Ermal Krasniqit, Qazim Laçit dhe Indrit Tucit; Jini krenarë për kombin dhe shtetet që përfaqësoni. Shqipëria dhe Kosova janë faktorë të rëndësishëm në



futboll dhe profesionalizmi i juaj do ta bëjë futbollin tonë të jetë primar në Evropë", ka shkruar Ademi.

Malisheva fiton derbin ndaj Llapit, Ballkani deklasoi Feronikelin '74

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Ballkani ka shënuar fitore ndaj skuadrës Feronikelit '74 me rezultat bindës 1-4. Në minutën e 15-të Halili shënoi autogol për rezultat 0-1. Mysafirët pas dy minutash shënuan edhe golin e dytë nëpërmjet Sunday. Pjesa e parë është mbyllur me këtë rezultat, kurse pesë minuta pasi filloi pjesa e dytë vendasit arritën ta ngushtojnë epërsinë në 1-2. Në minutën e 72-të, Ballkani realizoi edhe golin e tretë nëpërmjet Queven, derisa golin e katërt për mysafirët dhe të fundit në ndeshje e shënoi Karrica në minutat shtesë të ndeshjes. Pas kësaj ndeshje, Ballkani rrëmbeu pozitën e parë me 22 pikë. Në anën tjetër, "Nikli" është në vendin e fundit

në tabelë me tri pikë. Skuadra e Malishevës po vazhdon shkëlqimin në Superligën e futbollit, derisa të hënën e mposhti Llapin me rezultat 2-1. Pas tetë minutash, Valmir Berisha kalon vendasit në epërsi 1-0, derisa dhjetë minuta më vonë shënon edhe golin e dytë. Në pjesën e dytë Llapi u mundua t'i rikthejë në lojë të gjitha forcat dhe arriti ta ngushtojë epërsinë në 2-1, kur shënoi Mërgim Cërnavëri (68'), por kjo ishte e tëra që e arriti kjo skuadër në ndeshje. Pas tri pikëve të reja, Malisheva është e dyta në tabelë me 22 pikë, aq sa ka edhe skuadra e Ballkanit. Në anën tjetër Llapi mbetet në kuotën e 15 pikëve, ndërsa të dielën fitore kanë shënuar edhe Drita dhe Prishtina ndaj Suharekës dhe Ferizajt. Drita mposhti



shënues për vendësit, kurse për mysafirët shënuan Salifu

SUPERLIGA

Malisheva - Llapi	2-1
Feronikeli '74 - Ballkani	1-4
Prishtina - Ferizaj	1-0
Suhareka - Drita	1-2
Gjilani - Dukagjini	1-2

Tabela

	Pikë
1. Ballkani	22
2. Malisheva	22
3. Drita	21
4. Prishtina	19
5. Suhareka	17
6. Llapi	15
7. Dukagjini	14
8. Ferizaj	14
9. Gjilani	13
10. Feronikeli '74	3

Ibrahim dhe Albert Dabiqaj. Prishtina e mposhti me rezultat minimal Ferizajn, kurse golin e vetëm e shënoi Leotrim Kryeziu në minutën e 61-të.

Larry Thomas, MVP i javës së tetë në Superligë



MITROVICË, 4 NËNTOR - Java e tetë në ProCredit Superligën e Kosovës në basketboll solli disa përballje interesante. Derbi u zhvillua ndërmjet Trepçës dhe Bashkimit, ku prizrenasit fituan me 30 pikë dallim, 82:52. Te Trepça, Larry Thomas kishte 15 pikë, shtatë kërcime e katër asistime, duke u shpallur edhe MVP i kësaj xhiro. Ai u ndihmua nga Malik Johnson, i cili

kontribuoi me 15 pikë, katër kërcime e nëntë asistime. Peja shënoi fitore të rëndësishme, ndaj Vëllaznimit, ku te verdhezinjtë u dallua Jasquez Yow me dyshifrorë të dyfishtë prej 13 pikëve e 12 kërcimeve. Sigal Prishtina iu rikthye fitoreve, duke triumfuar ndaj Proton Cable Prizrenit. Edhe kësaj radhe te bardhekaltrit u dallua Damiree Burns, i cili e

mbylli ndeshjen me 23 pikë, 18 kërcime dhe një asistim.

MVP

Larry Thomas (Trepça) 15 pikë, 7 kërcime, 4 asistime, 22 indeksi

Top pesëshja

Larry Thomas (Trepça) 15 pikë,

7 kërcime, 4 asistime, 22 indeksi

Jasquez Yow (Peja) 13 pikë, 12 kërcime, 0 asistime, 20 indeksi
Malik Johnson (Trepça) 15 pikë, 4 kërcime, 9 asistime, 19 indeksi
Damiree Burns (Sigal Prishtina) 23 pikë, 18 kërcime, 1 asistim, 36 indeksi

Arian Qallaku (Golden Eagle Ylli) 14 pikë, 4 kërcime, 1 asistim, 12 indeksi

KB Drita shuan aktivitetin sportiv, shkak problemet financiare

GJILAN, 4 NËNTOR - Ka përfunduar rrugëtimi i Klubit të Basketbollit "Drita" meshkujt. Këtë lajm e ka dhënë lojtari i klubit, Qëndrim Demi. Përmes një njoftimi në "Facebook", Demi vijon të thotë se klubi "Drita" sot po mbyll kapitullin e tij më të rëndësishëm në fushën e sportit për shkak të vështirësive

financiare dhe mbështetjes së duhur. "Përfundon rrugëtimi i Klubit të Basketbollit 'Drita' meshkujt. Një klub me një histori të pasur dhe një trashëgimi të ndërtuar me mund e përkushtim nga breza të tërë, sot po mbyll kapitullin e tij të rëndësishëm në fushën e sportit", ka shkruar Demi.

Ndër të tjera, ai theksoi se "Drita" nuk ishte vetëm një klub. Sipas tij, ishte simbol i pasionit dhe i bashkimit të komunitetit. "Drita nuk ishte vetëm një klub, ishte simbol i pasionit dhe i bashkimit të komunitetit tonë. Ishte vendi ku qindra të rinj u formuan, ku fëmijët dhe të rinjtë e gjetën shpresën dhe krenarinë përmes

sportit. Mirëpo, për shkak të vështirësive financiare dhe mungesës së mbështetjes së duhur, ky udhëtim ka ardhur në fund", ka përfunduar ai. Megjithatë, Demi thotë se klubi sot po shuhet por, sipas tij, shpresa mbetet që një ditë të rilindë për t'i dhuruar komunitetit sërish.



Fitojnë Dallasi, Atlanta dhe Detroiti

DALLAS, 4 NËNTOR - Janë luajtur tri ndeshje në raundin e radhës në elitën e basketbollit amerikan NBA, ku fituan Dallas Mavericks, Atlanta Hawks dhe Detroit Pistons. Dallasi mposhti Orlandon me rezultat 108:85

dhe Luka Donçiqi udhëhoqi Mavericksin në një triumf rutinë. Slloveni e përfundoi ndeshjen me 32 pikë, 9 rebounde dhe 7 asistime, ndërsa në krahun tjetër më efektiv ishte Franz Vagner me

vetëm 13 pikë. Atlanta mundi New Orleansin 126:111 falë 29 pikëve të Jalen Johnsonit dhe 23 pikëve të Trae Youngut. Në anën tjetër, Brandon Ingrami shënoi 32 pikë. Detroiti mposhti Brooklynin me rezultat 106:92.

Deri në gjashtë lojtarë të Pistonsit patën një performancë dyshifrore. Më i larti (819) u shënuar nga Cade Cunningham. Në radhët e skuadrës së mundur, Cameron Johnson shënoi 26 pikë.



Bajrami, vendimtar për Rangersin: Treguam cilësitë tona, për fitore edhe ndaj Olympiacos

GLASGOW, 4 NËNTOR - Nedim Bajrami u shndërrua në protagonist të Rangersit teksa goli i tij i sollti fitoren 2-1 me përmbysje përballë Motherwell, duke i siguruar kualifikimin në finalen e Kupës së Ligës, që do të luhet pas një muaji përballë Celticit. "Ne treguam cilësitë tona sot dhe për 90 minuta besuam. Shënuam dy gola të këndshëm dhe në fund jemi në finale. Është gjithmonë e vështirë kur pëson gol ndaj skuadrash të tilla, por ne treguam durim në pjesën e dytë. Mund të shënonim edhe më shumë gola në pjesën e dytë dhe kjo është mënyra se si duhet të luajmë. Kemi ende kohë nga tani e deri te finalja ndaj Celticit, por mendoj se do të jetë një ndeshje e madhe ndaj jam i entuziazmuar", ka thënë Bajrami. "Goli? Ky ishte një kundërsulm i mirë dhe një pasim



i mirë nga Vaclav gjithashtu, mendoj se ishte edhe një finalizim i mirë nga unë dhe se po mundohem ta ndihmoj ekipin në çdo ndeshje. Po mundohem t'i marrim ndeshje pas ndeshje, pasi kemi shumë të tilla përpara. Pas tre muajsh këtu po ndihem mjaft mirë me shokët

e skuadrës dhe mundohem të ndihmoj me gola dhe asistime. Ne duhet të nisemi nga kjo fitore dhe të vazhdojmë këtë rrugë, pasi na presin shumë ndeshje. Kemi tani Olympiacosin dhe do të shkojmë atje të japim më të mirën dhe të fitojmë", ka deklaruar mesfushori shqiptar.

Verstappeni: Kjo ishte gara ime më e mirë e këtij sezoni

HASSELT, 4 NËNTOR - Max Verstappeni priti dhjetë gara për të fituar përsëri në Formula 1, por gjithçka ia vlejti. Triumfi i jashtëzakonshëm në garën e Brazilit ditën e diel, duke e nisur atë nga vendi i 17, do të mbetet gjatë në mendjen e fansave të Formulës 1. Një fitore që afron pilotin holandez të Red Bullit me titullin e katërt kampion bote, pasi tani ka +62 pikë ndaj Lando Norris. Madje ai mund të shpallet kampion bote që në garën e radhës, në Las Vegas, në rast se fiton dhe Norrisi merr vetëm një pikë. "Ky ishte ndoshta rikthimi më i mirë i karrierës sime, paksa i ngjashëm me garën time të vitit 2016 këtu. Nuk fitova atëherë, por kisha një ritëm shumë të mirë. Gjithsesi, kjo ishte një ditë e çmendur", u shpreh Verstappeni. "Para garës isha shumë i zemëruar pas kualifikimit. Ajo që ndodhi ishte shumë frustuese, por më motivoi. Jam befasuar



edhe vetë me rezultatën e garës, por në këto kushte shiu që u zhvillua gara ndihem mirë", u shpreh holandezi. "Makina bëri atë që doja dhe kur ekziston ai kombinim, siç ishte vitin e kaluar

në shumë gara, ne jemi të pandalshëm. Është një rezultat shumë pozitiv për ne dhe shpresoj se tani e tutje mund të qëndrojmë jashtë telasheve", ka shtuar Verstappeni.

SHKURT

Flick: Ndaj Espanyolit nuk ishim në nivelin e duhur

Pavarësisht se Barcelona e mposhti Espanyolin me rezultat 3-1, në një intervistë për "Mundo Deportivo", Hansi Flick ka thënë se ekipi i tij nuk ishte në nivelin e dëshirueshëm. "Një derbi është gjithmonë i komplikuar. Në pjesën e parë shfaqëm një nivel të mirë, por në përgjithësi nuk luajtëm ashtu siç bëjmë zakonisht. Ne humbëm shumë topa dhe u ndëshkuam në pjesën e dytë", ka thënë Flick. "Gjëja më e rëndësishme është fitorja dhe do të doja ta veçoja përqendrimin e të gjithë lojtarëve, disa prej tyre shumë të rinj. Në pjesën e dytë na mungoi presioni në atë që kishte topin dhe ne kishim disa probleme për shkak të kësaj", ka shtuar Flick.

Zverevi fiton turneun e fundit Masters dhe ngjitet në vendin e dytë në botë

Tenisti gjerman Alexander Zverev fitoi turneun e fundit Masters të vitit, atë të paris-Bercy. Në finale, ai mposhti 2-0 (6-2, 6-2) francezin Ugo Humbert. Një ndeshje pa histori, komanduar nga tenisti gjerman, që nga dita e sotme ngjitet në vendin e dytë të renditjes botërore, duke parakaluar Carlos Alcaraz. Ky i fundit u eliminua shumë herët nga turneu, duke zbritur në vendin e tretë. Për Zverev, ky është suksesi i shtatë në turnetë Masters, i 22-ti në karrierën e tij. Gjermani po kalon një moment të mirë dhe konsiderohet favorit edhe për ATP Finals që zhvillohen së shpejti në Torino, ku luajnë 8 më të mirët në botë.

Politano: Jemi të parët dhe do të reagojmë ndaj Interit

Humbja 0-3 ndaj Atalantas ishte një goditje e rëndë për Napolin, që gjithsesi ruan vendin e parë në renditjen e Serisë A. "Kjo ishte një ndeshje ku na mungonte energjia për ta gjetur golin. Gjithsesi, asgjë nuk ndryshon për ne, pasi jemi ende të parët në renditje. Tani kemi një tjetër sfidë të rëndësishme, atë ndaj Interit dhe duhet të reagojmë ashtu sikurse bëmë pas humbjes në javën e parë", ka thënë Matteo Politano, sulmues i Napoli. Duke iu rikthyer humbjes ndaj Atalantas, ai shtoi: "Na mungonte shkëndija përfundimtare për ta gjetur golin sepse kishim 3-4 mundësi në të cilat mund të kishim bërë më mirë. Në Serinë A nuk është asgjë e thjeshtë, por duhet të ringrihem". "Sezoni është i gjatë dhe kemi mundësi për të bërë më mirë. Ne e dimë se duhet të reagojmë shpejt, pasi i kemi mundësitë. Do të punojmë kokulur këtë javë për të mësuar nga gabimet dhe rikthyer te suksesi", ka deklaruar Politano.

Bayerni beson se Davies do ta rinovojë kontratën

Vazhdon të jetë ende e paqartë e ardhmja e mbrojtësit të majtë kanadez Alphonso Davies. Ylli kanadez është futur në vitin e fundit të kontratës dhe shumë

top klube duan transferimin e tij me parametra zero. Por te Bayern Munichu duket të jenë optimistë se Alphonso Davies mund të nënshkruajë një kontratë të re

dhe të qëndrojë me ta për një kohë të gjatë. Drejtori sportiv i "bavarezëve", Max Ebert, ka deklaruar pas fitores së tyre 3-0 ndaj Union Berlin: "Ka mundësi

që ai të rinovojë". Kjo vjen pasi kanë qarkulluar spekulime se Davies po kërkon qëllimisht një pagë jashtëzakonisht të lartë nga Bayerni për të mos nënshkruar

kontratë të re me ta. Real Madridi mbetet i etur për nënshkrimin e tij si agjent i lirë verën e ardhshme për ta forcuar pozicionin e tyre të mbrojtësit të majtë.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

FTESË PËR OFERTË FURNIZIM DHE SHËRBIM

Konform udhëzuesit të brendshëm për prokurim Nr 17-2023 për Autoritetin e likuidimit mbi procedurat e prokurimit duke shfrytëzuar fondet e likuidimit në mirëbesim

Data: 30.10.2024

I: AUTORITETI KONTRAKTUES: Agjencia Kosovare e Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit, ZR Prishtinë, ZR Pejë, ZR Prizren, ZR Gjilan dhe ZR Mitrovicë

NENI II: QËLLIMI I KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: *Bartja e dokumentacionit të vlershëm të NSH-ve në Likuidim - regjionit të Prishtinës, Prizrenit, regjionit të Pejës, regjionit të Mitrovicës dhe regjionit të Gjilanit, në Arkivat përkatëse*

II.2 Lloji i kontratës dhe lokacioni i dorëzimit:

Bartja e dokumentacionit të vlershëm të NSH-ve në Likuidim - regjionit të Prishtinës, Prizrenit, regjionit të Pejës, regjionit të Mitrovicës dhe regjionit të Gjilanit, në Arkivat përkatëse.
Lokacioni i dorëzimit është në AKP, ZQ Prishtinë - Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, 10.000 Prishtinë.

NENI III: KËRKESAT të cilat duhet të përmbushen nga OPERATORET EKONOMIK

IV.1 AFATI KOHOR PËR KËRKESAT E INFORMACIONEVE SHITESË OSE SQARUESE

IV.2 KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS

Oferta e përgjegjshme me çmim më të ulët

IV.2 Afati kohor për pranimin e tenderëve: më së voni më 14 Nëntor 2024 koha: 14:00.

IV.3 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 14 Nëntor 2024 **Koha:** 14:30:00 **Vendi:** Objekti e AKP-së, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, 10.000 Prishtinë

- Tenderuesit fitues dhe apo/eliminues do të njoftohen përmes emailit
- Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur dhe të vulosura. Shikoni me kujdes kushtet të cilat duhet të plotësoni.

Kërkesa për dosjen e tenderit: Dosja e tenderit mund të shkarkohet në webfaqen www.pak-ks.org.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Jeta Roka B.I" ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811143619 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Jeta Roka B.I", donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811143619 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Jeta Roka B.I" has come to the decision to quit its business: 811143619 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Domenik Gjoka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Burim Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Jetmir Malushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

